



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0850**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “INFINITT” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë “Spitali Sheikh Zayed” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Frigorifer dhe pajisje elektrike për kuzhinë” me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-10613-1-3-6, me 15/12/2023, mori:

## **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE “INFINITT” SH.P.K., me nr. 2023/0850 , e datës 30/10/2023, kurse vendimi i AK “Spitali Sheikh Zayed” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Frigorifer dhe pajisje elektrike për kuzhinë” me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-10613-1-3-6 anulohet, ndërkaq Vendimi i AK i datës 12.10.2023, Vërtetohet.

2. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës nga Operatorit Ekonomik “INFINITT” SH.P.K., të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës konform nenit 31 pika 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

## **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.10.2023, “Spitali Sheikh Zayed” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale”. Ndërsa me datën 12.10.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Mediatech & Print shpk”,

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 4,000.00 €.

Me 17.10.2023, OE “INFINITT” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 19.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 31/10/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “INFINITT” SH.P.K., me nr. 850/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Frigorifer dhe pajisje elektrike për kuzhinë” me numër të prokurimit 10/220/70050/00000/0731-23-10613-1-3-6.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “INFINITT” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

**Pretendimet e Operatorit Ekonomik:** “AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 12.10. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë OE Mediatech & Print sh.p.k. Qasje ne dokumente zyrtare kemi kërkuar me 13.10. dhe AK na ka aprovuar qasjen me 16.10. Nga dokumentet e OE te rekomanduar për kontratë te cilat kemi pranuar fizikisht ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm për arsyet si ne vijim:

1.OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk plotëson kriterin nr.1 lidhur me kapacitetin teknik & profesional pasi që nuk ka dorëzuar dëshmi se ka realizuar furnizime të ngjashme ne vlerën X1.5 mbi vlerën e planifikuar 6000.00euro. OE ka dorëzuar një liste të kontratave dhe disa dëshmi për furnizime mirëpo vetëm një prej tyre e kësaj lëmie kontratë e lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal me titull: Furnizim me pajisje tjera përmban produkte të kësaj lëmie dhe ka vlerën 2281.94 qe nuk arrin vlerën e kërkuar për furnizime te ngjashme ne vlerën minimale 6000euro. Te gjitha dëshmitë tjera nuk mund te pranohen si valide pasi që janë furnizim me material zyrtar, formular, produkte tjera te shtypit, printer, monitor, cd, inventar, televizor etj.

2. OE Mediatech&Print nuk ka plotësuar kriterin Nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik & profesional pasi që nuk ka dorëzuar Evidenca 2. Deklaratë mbi afatin e liferimit 5 dite (Origjinal). Ne dokumentet te cilat i kemi mare fizikisht ne qasjen ne dokumentet zyrtare mungon deklarata e liferimit po ashtu ne dokumentet të cilat figurojnë se janë dorëzuar ne formularin e tenderit nuk figuron deklarata e liferimit, për te sqaruar situatën i jemi drejtuar serish zyrës se prokurimit me 17.10 për deklaratën e liferimit dhe AK na ka dërguar deklaratën e liferimit te skanuar e cila nuk e dimë a është dorëzuar ne ofertim apo është kërkuar/plotësuar si dokument shtese megjithatë është e pavlefshme pasi që OE ka deklaruar se afati i liferimit është 20dite nga pranimi i urdhër blerjes ne këtë mënyrë OE është i papërgjegjshëm pasi që kërkesë/kriter ne dosjen e tenderit ka qene qe liferimi i mallit te behet brenda afatit 5dite.

3. OE i rekomanduar për kontrate nuk plotëson specifikimet teknike për pozicionin 1 ne paramase pasiqe AK ka kërkuar frigorifer ngjyre te bardhe ndërsa OE ka ofertuar ngjyre argjendi si dhe nuk janë ofruar të dhëna ne katalog lidhur me mbrojtjen antibakteriale.

4. OE i rekomanduar për kontrate nuk plotëson specifikimet teknike për produktin nr 3 ne paramase pasiqe është kërkuar minifrigorifer 41-50l ndërsa OE ka ofertuar frigorifer 40l. Niveli i lejueshmërisë është përcaktuar nga AK 41-50l ndërsa OE ka ofruar frigorifer nen këtë nivel.

5. OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm pasiqe për pozicionin 4 ne paramase Shporet elektrik nuk ka ofruar te dhëna ne katalog lidhur me funksionin Furra e gatimit me shume funksione dhe me ajër.

6. OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm pasiqe për pozicionin 5. Mikrovale nuk ka paraqitur të dhëna ne katalog lidhur me opsionin Programe: 6

“Autoriteti kontraktues ne përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim pika 2 ka cekur se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka dorëzuar ne ofertimin deklaratën e liferimit mirëpo AK ka kërkuar si sqarim shtese gjate vlerësimit të ofertave deklaratën e liferimit, AK nuk është dashur te kërkojë sqarime shtese/deklaratën e liferimit pasiqe është dokument i cili nuk mund te vërtetohet ne mënyrë objektive se ka qene i lëshuar para datës se dorëzimit të ofertave për projektin ne fjale ne mënyrë qe te jete ne harmoni me nenin 72.3 te LPP-se ne këtë mënyrë trajtimi preferencial për OE ne fjale përben favorizim. Po ashtu OE nuk i përmbahet kërkesës se AK qe liferimin e produkteve te beje brenda afatit 5dite ne deklarate është cekur se liferimin e produkteve do te beje ne afat 20dite nga pranimi i urdhër blerjes. Autoriteti kontraktues ne përgjigje të kërkesës për ri-shqyrtim ne piken 6 pretendon se kompania jone ka manipuluar specifikat për pozicionin 5 Mikrovale duke sqaruar se produkti Mikrovale Gorex GRX MM 20 WHT është produkt i Interplast Group dhe ka 5 funksione. Ky konstatim i AK nuk qëndron, ky produkt nuk është prodhim i Interplast Group si dhe ne kemi ofertuar serine Mikrovalë Gorex – GRX MM20WHT model me specifika te ndryshme nga modeli WHT si dhe ofertën & specifikimet kemi pranuar nga furnitorë jashtë vendit tone. Shkelje tjetër procedurale e cila ka ndodhur ne këtë aktivitet te prokurimit është se AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit pas pranimi te kërkesës për ri-shqyrtim konform pikës 2 te nenit 108/a te LPP-se. Bazuar ne faktet e lartcekura konstatojmë se AK ka rekomanduar për kontrate OE te papërgjegjshëm i cili nuk plotëson kriterin nr.1 dhe nr. 2 lidhur me kapacitetin teknik & profesional dhe specifikimet teknike për pozicionet 1, 3, 4, 5 ne paramase.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “INFINITT” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 28, 59, 60, 69, dhe 108/A të LPP-së, si dhe neni 19 dhe 41 të Rruopp-së . Duke propozuar qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

**Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim.** “Si oferta e OE "INFINITT" SH.P.K dhe dy ofertat tjera të OE janë vlerësuar nga ana e komisionit me shumë kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, si dhe në bazë të Nenit 60 të LPP-së, ka rekomanduar që OE "MEDIATECH & PRINT" SH.P.K të shpërblehet me kontrate publike pasi që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. I. Tek kapaciteti teknik/profesional, komisioni vlerësues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontrata ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që ka realizuar kontrata të ndryshme në afate kohore, ku një

nder kontratat e realizuara është e natyrës së ngjashme që është kërkuar në kriterin nr. 1 tek kapaciteti teknik /profesional.2.Lidhur me kriterin nr.2 të kapacitetit teknikë profesional, OE deklarimin e afatit të liferimit e ka cekur se do të përmbahet kushteve të afatit të liferimit sipas Dosjes së Tenderit të shpallur nga AK: Spitali Sheikh Zayed, të cilën deklaratë e ka potencuar tek Deklarata me shkrim e specifikacionit, me këtë rast gjatë vlerësimit të ofertës, OE ju është kërkuar sqarime lidhur me deklaratën e liferimit siç është kërkuar tek kapaciteti teknik/profesional në DT.3.Lidhur me pozicionin nr. 1 të specifikacionit teknik, komisioni vlerësues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar paramasat e kërkuara për Frigorifer të kombinuar, ndërsa sa i përket ngjyrës ju njoftojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar me ngjyre argjendi siç ka potencuar OE "INFINITT" SH.P.K. Në katalog nuk është e cekur ngjyra por vetëm fotoja se si duket modeli i Frigoriferit, kështu që OE fitues gjatë ekzekutimit të kontratës e ka obligim që Frigoriferin ta sjell me ngjyre të bardhë sipas përshkrimit në specifikacionin teknik të DT.Lidhur me pozicionin nr.3 të specifikacionit teknik në të cilin pozicion është kërkuar Furnizim me frigorifer për zyre dhe me kapacitet prej 41L+50L.Komisioni vlerësues pas shqyrtimit të ofertave ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me specifika Frigorifer të vogël të cilat i përshtaten AK.

4.Në pozicionin nr.3 OE "INFINITT" SH.P.K ka ofertuar me Frigorifer Minibar i tejdukshëm si në katalogun e prezantuar i cili nuk i përshtatet AK dhe para masave në specifikacionin teknik të DT.5.Lidhur me pozicionin nr.4 të specifikacionit teknik, komisioni vlerësues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar paramasat e kërkuara për Shporet Elektrik indesit, ku dihet se Shporet Indesit i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë në bazë të katalogut e kanë funksionin e gatimit me shumë funksione dhe me ajër. OE "INFINITT" SH.P.K për pozicionin nr.4 në prezantimin e katalogut ka ofertuar me Shporet elektrik që nuk është “ INDESIT”, ndërsa në paramasat e kërkuara në specifikacionin teknik të DT Është kërkuar Shporet elektrik Indesit. 6.Lidhur me pozicionin nr.5 të specifikacionit teknik, komisioni vlerësues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar paramasat e kërkuara për Mikrovalor dhe ka konstatuar se ka me shumë se 6 programe të funksionimit. OE "INFINITT" SH.P.K për këtë pozicionin nr.5 ka ofertuar në bazë të katalogut me Mikroval Gorex me 6 funksione. Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertës se OE "INFINITT" SH.P.K., ka vërejtur se ka dyshime se është manipuluar me paramasat e prezantuara në katalog ku është bërë ndryshimi i programit nga 5 në 6 programe, më qellim të përshtatjes së paramasave të kërkuara në specifikacionin teknik të DT, këtë dyshim për manipulim e dëshmojmë në vijim:Pozicioni nr.5 i prezantuar në katalogun e OE "INFINITT" SH.P.K është produkt i INTERPLAST GROUP me specifika origjinale. Mikrovalë Gorex - GRX MM20WHT• Dimensionet e Produktit( HxWxDcm): 32.4x45x26.5 Fuqia: \* 700W, \* Kapaciteti: 2013. ,\*Funksione: 5, \*Klasa e Energjisë: A.

AK do të respekton Nenin 7,paragrafin 1 ku thuhet "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktuesi Spitali "Sheikh Zayed"-Vushtrri e refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të pa bazuar.”

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/11/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 850/23, ndërsa me datë 23/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0850 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të

kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues nuk është përgjegjës për raportin e ekspertizës . Ndërsa OE Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “INFINITT” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0850 ka vlerësuar si në vijim:

**-Konstatimi (I) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional ekspertit shqyrtues sqaron se me dosje të tenderit është kërkuar: Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë të kontratave të natyrës se ngjashme të përfunduar me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë, të përcjella me referenca apo raporte të pranimit 1.5 here të vlerës së parashikuar. Evidenca 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë të kontratave të natyrës se ngjashme të përfunduar me sukses në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë, të përcjella me referenca apo raporte të pranimit 1.5 here të vlerës së parashikuar. Duke pas parasysh vlerën e përlogaritur atëherë OE pjesëmarrës në aktivitet të prokurimit është dashur të përmbushin vlerën prej 6,000.00 € për kërkesën si më lartë. OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave ka dorëzuar referenca për kontratë të cilat janë brenda kërkesës së AK-së dhe sipas referencave i plotëson dhe i tejkalon për disa here kërkesat e dosjes së tenderit. Nga lista e kontratave mund të identifikohen kontratë të furnizimit për të cilat janë dorëzuar edhe referencat si: Kontratat me nr rendor 3, 12, 13, 14, 21, 22, 33, 36 dhe 38 që së bashku i tejkalojnë për disa kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka vepruar në përputhje me nenin 69 të LPP-së lidhur me nenin 26.8 të RRUOPP dhe se pretendimi i OE ankues për këtë pikë **nuk është i bazuar.**”

**- Konstatimi (II) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me afatin e liferimit e që lidhet me kërkesën e dytë të kërkesave teknike & profesionale ekspertit shqyrtues sqaron se sipas dosjes është kërkuar: Kërkesa 2. Deklarata mbi afatin e liferimit 5 ditë. Evidenca 2. Deklarata mbi afatin e liferimit 5 ditë (Origjinal). OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar një deklaratë “Deklaratë Me Shkrim E Specifikacionit” në të cilën ka deklaruar se “do iu përmbahemi kushteve, specifikave teknike dhe afatit të liferimit sipas dosjes së tenderit”. Përkundër faktit se është dorëzuar një deklaratë, AK-ja në kërkesën për rishqyrtim ndaj OE i ka dërguar një deklaratë tjetër nga OE i rekomanduar për kontratë në të cilën “deklaron se do të liferojë brenda 20 ditëve nga marrja e urdhër blerjes”. (komunikimi në mes të AK-së dhe OE ankues) Eksperti shqyrtues ka kërkuar nga AK-ja edhe një sqarim mbi deklaratën e OE ankues ku kam pranuar përgjigjen sikurse e përshkruar në **“sqarimet e kërkuara”** ku kanë bashkangjitur një deklaratë e cila është e njëjtë me deklaratën e dorëzuar me ofertë. Duke pas

parasysh se gjate vlerësimit nga AK dhe kërkesës për rishqyrtim nga OE ankues ka diskrepance ne paraqitjen e dokumenteve te cilët pasqyrojnë deklarata te ndryshme nga kërkesat e dosjes se tenderit eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk e ka vlerësuar ofertën e OE te rekomanduar për kontratë në përputhje me nenin 59 paragrafi 2 dhe 4 si dhe Neni 7 i LPP-së, rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë **është pjesërisht i bazuar.**”

**- Konstatimi (III) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin qe ka të bëjë me specifikimin teknik të dosjes së tenderit pozicioni 1 i Aneksit 1 eksperti shqyrtues sqaron se me specifikim teknik është kërkuar: \* Mbrojtje Anti-bakteriale, \* Klasa energjisë: A+, \* Kapaciteti neto: 343 L, \* Kapaciteti i frigoriferit: 230 L, \* Kapaciteti i frizit: 113 L, \* Dispensorë uji , \* Ndriqim I brendshëm LED, \* Përmasat: 185x60x67cm, \* Ngjyra: Bardh. Pretendimi i OE ankues është për ngjyrën dhe mbrojtjen antibakteriale e cila ishte adresuar përmes kërkesës për rishqyrtim por qe pjesa e mbrojtjes antibakteriale nuk ishte adresuar e qe ishte kërkuar me specifikim teknik. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në bazë të Nenit 59.2 te LPP-se lidhur me nenin 39.2, 39.3 të RRPP 001/2022 mund të kërkojë sqarime shtesë me kusht që asnjë ndryshim material në aspektin e tenderit mos të pranohet. Prandaj bazuar ne sqarimet si me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë pikë **është pjesërisht i bazuar.**”

**-Konstatimi (IV) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin qe ka të bëjë me specifikimin teknik të dosjes se tenderit pozicioni 3 i Aneksit 1 eksperti shqyrtues sqaron se me specifikim teknik është kërkuar: \* Kapaciteti : 41L ÷ 50 L, \* Klasa energjisë: A+, \* Përmasat: 52 cm x 43 cm x 47 cm, \* Ngjyra: Bardh. Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me pozicionin e kapacitetit të pajisjes. AK-ja në bazë të specifikimit teknik ka kërkuar qe pajisja të ketë kapacitet prej 41litra deri 50 litra. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar pajisjen me 40 litra e që është në kundërshtim me kërkesat e specifikimit teknik. AK –ja gjatë vlerësimit te ofertës së OE te rekomanduar për kontratë nuk ka respektuar nenin 45.18 te RRPP 001/2022 dhe Nenin 7 te LPP-së, rrjedhimisht pretendimi i OE në këtë pikë **është i bazuar.**”

**-Konstatimi (V) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin qe ka të bëjë me specifikimin teknik të dosjes se tenderit pozicioni 4 i Aneksit 1 eksperti shqyrtues sqaron se me specifikim teknik është kërkuar: \* Kapaciteti i furrës 63L, \* Furra e gatimit me shume funksione dhe me ajër, \* Klasa energjisë: A, \* Përmasat: 85 cm x 60 cm x 60 cm. \* Numri i Funksioneve të Pjekjesë: 5, \* Numri i zonave: 4 ndezës deri në 2100W. Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me pozicionin e parë të specifikimit teknik qe sipas ekspertit shqyrtues është i njëjtë me pretendimin e 3 dhe rrjedhimisht AK-ja ka mundur ta trajtojë në mënyrë të njëjtë sipas RRPP 001/2022 prandaj vlerësoj se sikurse pretendimi i tretë edhe në këtë rast pretendimi i OE ankues është **pjesërisht i bazuar.**”

**-Konstatimi (VI) i ekspertit shqyrtues** “Lidhur me pretendimin qe ka te beje me specifikimin teknik të dosjes se tenderit pozicioni 5 i Aneksit 1 eksperti shqyrtues sqaron se me specifikim teknik është kërkuar: \* Fuqia : 700W, \* Kapaciteti: 20L, \* Programe: 6, \* Sistemin e shkrirjes. Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me pozicionin e programeve të pajisjes. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar pajisjen me 9 nivele të fuqisë e që është në pajtim me kërkesat e specifikimit teknik. Prandaj bazuar në dosjen e tenderit dhe ofertën e OE te rekomanduar për kontratë pretendimi i OE ankues ne këtë pike **nuk është i bazuar.**”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “INFINITT” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i

referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertëve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “INFINITT” SH.P.K., - Prizren janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku ka vendosur se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të cilat pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër. Në këtë mënyrë është gjetur se AK ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Frigorifer dhe pajisje elektrike për kuzhinë” me numër të prokurimit: 10/220/70050/00000/0731-23-10613-1-3-6. Pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pa bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Frigorifer dhe pajisje elektrike për kuzhinë” me numër të prokurimit: 10/220/70050/00000/0731-23-10613-1-3-6, të vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, lidhur me pohimet e ankuesit ka vërejtur se eksperti në raportin e tij kishte aprovuar vetëm pretendimin nr.4 (shih: *më sipër tek konstatimet e ekspertit*) sa i përket “litrave të pajisjes” ku sipas tij/saj ishte kërkuar 41L kurse i rekomanduari kishte ofruar me 40 L, ndërsa ka refuzuar pretendimin 1 dhe 6, kurse pretendimet tjera i ka cilësuar vetëm si pjesërisht të bazuara, të sqaruara si më sipër pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen sërish në detaje.

Paneli sqaron se lidhur me pretendimin 2 për “afatin e liferimit te produkteve” nga OE i rekomanduar, (i cilësuar si pretendim pjesërisht i bazuara nga ana e ekspertit shqyrtues) AK në përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, kishte sqaruar se OE i rekomanduar deklarimin e "afatit te liferimit" e kishte cekur tek përmbajtja e “deklaratës me shkrim të specifikacionit teknik e dorëzuar në ofertën e tij/saj” ku kishte potencuar, se do ti përmbahet kushteve të afatit te liferimit sipas Dosjes së Tenderit, kurse e njëjta pastaj ishte sqaruar në detaje nga ana e Komisionit të vlerësimit brenda AK, në rrethana të tilla nuk mund të konsiderohet si ndryshim material i ofertës prandaj paneli e cilëson këtë pretendim si të pabazuar në fakte dhe argumente bindëse.

Lidhur me pretendimin 3 ku sipas ekspertit duhet të kërkohen sqarime shtesë, paneli sqaron se AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka sqaruar se komisioni vlerësues kishte konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar paramasat e kërkuar për “Frigorifer të kombinuar” ndërsa sa i përket ngjyrës ka theksuar se OE i rekomanduar për kontratë, nuk kishte ofertuar me ngjyre argjendi siç ka potencuar ankuesi, ngase në katalog nuk është e cekur fare ngjyra, por vetëm fotoja se si do të dukej si model Frigoriferi, po ashtu ka shtuar me tej se “OE fitues” gjate ekzekutimit të kontratës e ka për obligim që Frigoriferin ta sjell me ngjyre të bardhë sipas përshkrimit në specifikacionin teknik të DT dhe sipas deklaratës së nënshkruar nga vet ai për specifikacione teknike, ekspertit shqyrtues sa i përket këtij pretendimi dhe pretendimit vijues nr 4 i kishte cilësuar si pjesërisht të bazuara megjithatë nuk kishte ofruar ndonjë argument apo provë bindëse. AK mes tjerash kishte pohuar se OE i rekomanduar për kontratë e kishte plotësuar paramasën e kërkuara për “Shporet Elektrik Indesit”, ne bazë të katalogut konstatohet se kanë funksionin e gatimit me shume funksione dhe me ajër dhe nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit, kurse sa i përket ofertës së Ankuesi OE "INFINITT" SH.P.K për të njëjtin pozicion nr.4 sipas AK, ankuesi në katalog kishte ofertuar me “Shporet elektrik” e që rrjedhimisht nuk është “INDESIT” sipas kërkesës së DT. Tutje pretendimi nr 5, i cilësuar edhe ky si pjesërisht i bazuar nga eksperti, AK ka pohuar po ashtu se OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar edhe këtë paramasë të kërkuar për "Mikrovalor" dhe ka konstatuar se i njëjti ka më shumë se 6 programe te funksionimit, kurse lidhur me ofertën e OE ankues "INFINITT" SH.P.K për pozicionin nr.5, AK ka pohuar se të njëjtit kanë ofertuar ne baze te katalogut me “Mikroval Gorex me 6 funksione” kurse Komisioni vlerësues ka pohuar se ka dyshime se katalogu është manipuluar nga ankuesi me “paramasat e prezantuara në katalog” ku është bërë ndryshimi i programit nga 5 në 6 programe, me të vetmin qellim të përshtatjes së paramasave të kërkuara në specifikacionin teknik të DT, kurse këtë dyshim për manipulim e kanë dëshmuar si në vijim: Pozicioni Nr.5 1 prezantuar ne katalogun e OE "INFINITT" SH.P.K është produkt i INTERPLAST GROUP me specifika origjinale. Mikrovalö Gorex - GRX MM20WHT• Dimensionet e Produktit( HxWxDcm): 32.4x45x26.5 Fuqia: \* 700W, \* Kapaciteti: 2013. ,\*Funksione: 5, \*Klasa e Energjisë A, nga ana tjetër ankuesi ka pohuar se nuk është produkt i Interplast siç pohon AK por nga vendet tjera. Sa i përket këtij pretendimi, Paneli vlerëson se nëse ekzistojnë dyshime të tilla, të njëjtat duhet të argumentohen me prova konkrete dhe bindëse nga ana e AK, pastaj ti drejtohen OSHP për ndërmarrjen e masave ligjore ndaj Operatorin Ekonomik në përputhje me nenin 99.2 të LPP.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bje ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-

vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*” kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme,

Andaj mbi bazën e të lartëcekurave, paneli konstaton se oferta e OE te rekomanduar për kontratë ka çmim reth 35% më të lirë se ankuesi, kurse vlera e parashikuar e tenderit ishte 4,000.00euro, andaj vendosi të lë në fuqi vendimin e AK, gjithnjë duke u bazuar në provat e administruara dhe vlerësimet e bëra edhe nga ana e komisionit të vlerësimit të cilët sipas LPP janë përgjegjës edhe individualisht sipas nenit 59.1 të LPP, nga ana tjetër eksperti nuk ka ofruar ndonjë prove bindëse dhe konkrete që ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në Rivlerësim, kurse pohimet ankimore kryesisht ndërlidhen me specifika teknike të pajisjeve, andaj në këtë rast paneli vlerëson se mbetet nën diskrecion të AK që të njëjtat ti konsideroj apo jo si devijime të vogla në përputhje me nenin 59 paragrafi 4 i LPP duke u ndëlidhur edhe me nenin 24.2 cituar: *Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të till kontraktues të ekzekutohen në përputhje të plotë me këtë ligj.*

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 1,6,7, lidhur me nenin 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - SPITALI SHEIKH ZAYED**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: